



Datë: 14.04.2026
Numër Protokolli: 1954/2026

A.nr.189/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj-Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.189/2026, të datës 20.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.K, kundër organit të punësimit/Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike “*Kontest nga marrëdhënia e punës*”, bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.189/2026, të datës 20.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.K.

A r s y e t i m

Ankuesi F.K, më datë 20.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar në shenjën A.nr.189/2026, kundër Vendimit me numër 04/26, të datës 21.01.2026, të u.d. Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me të cilin z. N.N është caktuar Ushtrues Detyre i Drejtorit të Departamentit të Kadastrit, ndërsa, i njëjti më datë 07.04.2026 (përmes e-mailit zyrtar) ka përcjell deklaratën për tërheqje nga ankesa të datës 20.02.2026, me arsyetimin se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë tashmë janë përmbushur.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 07.04.2026 të ankuesit për tërheqje nga ankesa e datës 20.02.2026, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, dhe si rrjedhojë, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës A.nr.189/2026, të datës 20.02.2026.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.189/2026

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, F.K;
- Menaxheres se Personelit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së